



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic Of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina**

---

**Drejtoria e Planifikimit Strategjik**  
**Raporti mujor, Qershor 2022**

**PROJEKTET :**

- Përgatitja dhe printimi i materialeve për takimet me banorët e lagjeve;
- Koordinimi me drejtorinë e Parqeve për hapat që duhet ndërmarrë në përgatitjen e projekteve;
- Prezantimi grafik i sinjalizimit horizontal, për personat me shikim të dëmtuar, për sportelet në Komunën e re si dhe sportelet në Komunën e vjetër;
- Dakordimi për lokacionin e IP në lagjen Kalabria;
- Propozimi i tre lokacioneve për Institucionet parashkollore në lagjet: Kalabria, Mati 1 dhe Vneshtat;
- Koordinimi me NPB-ne për mundësinë e ndryshimit të projektit për parkun në Prugovc;

**AKTIVITETET:**

- Informim i palëve për kriteret e planeve sipas kërkesave;
- Takimet me palë janë zhvilluar normalisht sipas ditëve të caktuara;
- Vazhdim i angazhimit rreth hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale;

- Vazhdim i angazhimit rreth hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për lagjet Kalabria dhe Dardania;
- Definim i vizionit për platformën( portalin) GIS nga drejtorët e drejtorive;
- Diskutim publik me banorët e lagjes “Prishtina e vjetër” për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale;
- Diskutim publik me banorët e lagjes “ Mati “ për Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale.

### **VIZITAT NË TEREN:**

- Vizitë në terren në lagjen Bregu i Diellit (shqyrtimi i kërkesës së banorëve për rregullimin e hapësirave të përbashkëta);
- Analizimi i gjendjes ekzistuese për rigjenerimin e hapësirës publike në rrugën “Hyzri Talla”.

### **TAKIMET:**

- Takim koordinues në lidhje me vazhdimin e projekteve në qytet;
- Takime të rregullta me Task Forcën për unazën qendrore;
- Takim me MMPH për koordinimin e procesit për PZHK-në dhe HZK-në.